



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.8/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.A, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J..., me banim në lagjen “Q...”, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 16.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga I.H, nga Juniku, ndaj gjyqtarit B.A, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 05.07.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J..., me banim në lagjen “Q...”, ndaj gjyqtarit B.A, me arsyetimin se lënda për sulmin fizik dhe lëndimet nga A.K, lënda gjyqësore e cila nuk po përfundohet nga gjyqtari sepse gjyqtari A... është i korrupsuar nga A.K nga J... Thekson se gjyqtari thirret në raporte mashtruese nga punëtori social B.F nga J... dhe me diagnoza të shpifura, të fryra me gënjeshtër dhe shpifje të një neuropsikiatri nga Gjakova. Ndër tjera thekson se përveç sulmit fizik nga A.K, për të cilën është në zhvillim e sipër procedura tek gjyqtari B.A, ekziston edhe rasti i datës 17.05.2024, ku i njëjti është sulmuar dhe lënduar nga daja i A.K nga Juniku, Xh.Sh., lëndë në gjykim tek gjyqtari V.A. Në deklaratimet e tij thekson edhe mosmarrëveshjen me ish gruan më të cilën është shkurore, lëndë e cila ka qenë në punë tek gjyqtari A... Tutje thekson se gjyqtari B.A dhe B.F janë shok të A.K. Ndër tjera konsideron absurde se “kush po e urdhëron apo mban në grusht gjyqtarin A... me e thy me dy duar ligjin dhe drejtësinë e Republikës së Kosovës”.

Me datë 08.07.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, ndaj gjyqtarit B.A.

Gjyqtari B.A, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se për lëndën C.nr.162/16, të datës 04.12.2017, me bazën juridikë zgjidhje e martesës. Me aktgjykim është zgjidhur martesë në mes paditësit I.H nga J... dhe të paditurës

B.H nga J... Ky aktgjykim është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi. Pala ka pas të drejtën të ushtrojë ankesë kundër aktgjykimit. Andaj çdo pretendim i palës që ka për qëllim degradimin e tij profesional dhe personale, është i pa qëndrueshëm, i pa baze dhe pa asnjë arsyetim konkrete. Sepse i njëjti as ne ankesën e tij nuk e ka qarte çka kërkon dhe qëllimi i tij duket të jete degradimi profesional dhe asgjë me tepër. Ndërsa sa i përket pretendimit për lëndën C.nr.477/2023, deklararon se me datën 07.11.2023 e ka dhënë një deklaratë drejtuar kryetarit të gjykatës, lidhur me pretendimet e ankuesit I.H nga J... Potencion faktin se mbetet në tersi pranë asaj deklaratë të datës 07.11.2023, sepse edhe këtu i njëjti pa asnjë prove dhe fakte e akuzon për çështjet për të cilat sipas gjyqtarit nuk qojnë peshe dhe nuk kanë relevanc për vendosje në çështjen civilo-juridike, por qëllimi i të njëjtit dihet mirëfilli se është përjashtimi e gjyqtarit nga kjo lëndë dhe për çështje ka vendose kryetari i gjykatës.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.A, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore dhe gjeti se pretendimet në fjalë janë të paargumentuara me asnjë provë dhe shumë të përgjithësuara. Pretendimi se gjyqtari është i korruptuar nga A.K, pretendimet se i njëjti thirret në raporte mashtrues nga punëtori social B.F, si edhe pretendimi se gjyqtari A... dhe B.F janë shok të A.K, këto pretendime nuk janë mbështetë me asnjë provë dhe nuk janë argumentuar në asnjë mënyrë nga ana e parashtruesit të ankesës, dhe si të tilla mbeten vetëm supozime të palës ankuese.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit se “kush po e urdhëron apo mban në grusht gjyqtarin A... me e thy me dy duar ligjin dhe drejtësinë e Republikës së Kosovës”, i cilin pretendim i parashtruesit të ankesës duke mos qenë i argumentuar mbetet vetëm një supozim i palës ankuese, në të kundërtën i njëjti ftohet që në rast se posedon prova që i mbështetin dyshimet e tilla të njoftojë autoritet kompetente për zhvillim të hetimeve të mëtejme. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.8/24, me datë 16.07.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.A*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.H, nga J...*